



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
DREJTORIA E KOORDINIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I KOORDINIMIT, STUDIMEVE DHE INTEGRIMIT

Nr. 1351/prot.

Tiranë, më 25.09.2023

Lënda: Kthim përgjigje.

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

TIRANË

Në përgjigje tuajës Nr.6714 Prot., datë 02.09.2023, me të cilën kërkon informacion për hetimin e veprave penale në fushën e zgjedhjeve, sa i përket zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, ju përcjellim informacionin si më poshtë:

- Nga të dhënat e Zyrës së Statistikës në Prokurorinë e Përgjithshme dhe verifikimet me zyrat e regjistrimit në prokuroritë e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, rezulton se për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, janë regjistruar gjithësej 44 kallzime penale lidhur me vepra penale në fushën e zgjedhjeve.
- Nga këto 22 janë regjistruar procedime penale (një procedim është regjistruar për një vepër penale tjetër, por që lidhet me situatën zgjedhore), për 15 kallzime është vendosur mosfillimi i hetimeve dhe 2 kallzime janë akoma në proces verifikimi. Të gjitha procedimet penale të regjistruara janë në fazën e hetimeve paraprake dhe nuk ka asnjë vendimmarrje për mënyrën e përfundimit të tyre.
- Janë kaluar për kompetencë hetimi në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, 5 kallzime penale dhe 3 procedime penale.
- Të ndara sipas rretheve kallzimet/procedimet penale janë si vijon: Prokuroritë e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka regjistruar 8 kallzime penale, prej tyre 3 procedime penale, një nga këto procedime i ka kaluar SPAK, për 4 kallzime është vendosur mosfillimi dhe 1 kallzim është akoma në fazë verifikimi. Prokuroria Durrës ka regjistruar 9 kallzime penale, prej të cilave 7 procedime penale dhe për 2 kallzime është vendosur mosfillimi. Prokuroria Elbasan ka regjistruar 7 kallzime penale, prej tyre 4 procedime penale, për dy kallzime është vendosur mosfillimi dhe 1 kallzim i është kaluar për kompetencë SPAK. Prokuroria Shkodër ka regjistruar 2 kallzime penale, prej tyre 1 është regjistruar procedim penal dhe 1 i është kaluar për kompetencë SPAK. Prokuroria Vlorë ka regjistruar 3 kallzime penale, prej tyre 2 janë regjistruar procedime penale, prej të cilave 1 procedim dhe 1 kallzim penal i ka kaluar SPAK dhe një procedim është në

ndjekje nga kjo prokurori. Prokuroria Kukës ka regjistruar 5 kallëzime penale, prej të cilave 1 kallëzim i ka kaluar për kompetencë SPAK, 1 kallëzim është regjistruar procedim penale për vepra të tjera por që lidhet me zgjedhjet dhe për 3 kallëzime është vendosur mosfillimi. Prokuroria Korçë ka regjistruar 1 kallëzim penal që është regjistruar procedim dhe është në fazë hetimi. Prokuroria Dibër ka regjistruar 2 kallëzime penale për të cilat është vendosur mosfillimi. Prokuroria Berat ka regjistruar 2 kallëzime penale për të cilat është regjistruar procedim penal dhe janë në fazë hetimi. Prokuroria Fier ka regjistruar 2 kallëzime penale, një prej tyre është regjistruar procedim penal dhe kaluar për kompetencë në SPAK, kallëzimi tjetër është në fazë verifikimi. Prokuroria Gjirokastër ka regjistruar 2 kallëzime penale, për një prej tyre është vendosur mosfillimi dhe kallëzimi tjetër është regjistruar procedim penal dhe i ka kaluar për kompetencë SPAK. Prokuroria Sarandë ka regjistruar 1 kallëzim penal, të cilin e ka regjistruar procedim penal dhe është në fazë hetimi.

- Të ndara sipas rretheve kallëzimet/procedimet penale janë si vijon regjistruar për veprat penale të parashikuara nga nenet 326/a, 327/1, 328, 328/a/1, 329, 330, 331/a, 190, 248, 84 të Kodit Penal.
- Janë regjistruar si persona nën hetim 13 persona, prej të cilëve 6 janë arrestuar në flagrancë dhe 1 është i ndaluar. Ndaj dy personave është caktuar masa e sigurimit “Arrest në burg” parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale dhe ndaj 5 personave është caktuar masa e sigurimit “Arrest në shtëpi” parashikuar nga neni 237 i K Pr Penale.
- Nga 13 personat të cilëve u është atribuar vepra penale, 6 prej tyre i kanë kaluar për kompetencë Prokurorisë së Posaçme dhe 7 janë në procedimet penale që po hetohen nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, 2 prej tyre nga Prokuroria Sarandë dhe 5 nga Prokuroria Elbasan.
- Në lidhje me personat nën hetim rezultojnë 1 femër, banuese në Konispol dhe 6 meshkuj, 5 prej tyre banues në Cërrik dhe 1 banues në Konispol, me gjendje gjyqësore të pa dënuar, të grupmoshave 28 deri në 43 vjeç.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin,

DREJTORI

KOSTAQ BELURI

